



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/ 270

Data: 16.06.2023

PODUJEVË

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës, nr. 03/L-212 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr.04/L – 032, të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës, Drejtoria e Arsimit, shpall :

KONKURS

Vendi i punës: Specialist/e i/e IT-së

Pozita: 1 (një)

Koeficienti: 8.10

Orari i punës: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për funksionin e të gjitha pajisjeve të IT-së, për të krijuar një sistem funksional në përputhje me nevojat dhe kërkesat e DKA-së dhe të gjitha institucioneve edukativo-arsimore;
- Bën instalimin, konfigurimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të IT- së në DKA dhe në të gjitha institucionet edukativo - arsimore;
- Asiston dhe ndihmon në mirëmbajtjen e Webfaqeve të institucioneve edukativo - arsimore;
- Zhvillimi dhe administrimi i të gjitha data bazave të shkollave, si dhe identifikon, hulumton dhe zgjidh probleme teknike;
- Sipas nevojave ofron asistencë dhe ndihmon shfrytëzuesit e pajisjeve teknologjike në rast se ka probleme me kompjuter dhe pajisje të tjera të IT-së në të gjitha institucionet edukativo arsimore;
- Kryen edhe detyra të tjera që korrespondon ose mund të ndihmoj në kryerjen e funksioneve brenda DKA-së dhe institucioneve edukativo - arsimore.

Kushtet për punësim:

- Diplomë universitare së paku 3 vite të studimeve, kualifikime të posaçme formale: Teknologji Informative, Shkenca Kompjuterike, Menaxhment dhe Informatikë.

]

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopja e vërtetuar e përgatitjes shkollore;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata e lindjes;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Vërtetimi që dëshmon se nuk është nën hetime;
- Letër rekomandimet;
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore (pas pranimit të kandidatit në vendin e punës).

Afati i aplikimit

Data e njoftimit në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës **16.06.2023** deri më datën **15.07.2023**, ndërsa **koha e aplikimit** është nga data **17.07.2023** deri më datën **31.07.2023**.

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës-<http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës, pas mbylljes së konkursit.

Drejtori

Avni Fetahu

